



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Në mbështetje të Rregullores së MF. nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ, Vendimin nr. 99 të datës 17/08/2023 të Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Drejtësisë për thirrjen publike për mbështetje financiare publike për projektet e OJQ-ve të licencuara në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare, Vendimit nr. 28 të datës 15/03/2023 të Sekretares të Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë për themelimin e komisionit vlerësues për përzgjedhjen e projekteve për mbështetje financiare publike të OJQ-ve, Komisioni vlerësues nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHEN** kërkesat e OJQ-ve sipas thirrjes publike të Ministrisë së Drejtësisë për mbështetje financiare publike për projektet e OJQ-ve të licencuara në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare për vitin 2023 (si më poshtë nga nr. 1-4):
1. OJQ, Asociacioni Nacional i Autizmit në Kosovë – ANAK, Prishtinë;
 2. OJQ, Shoqata e Paraplegjikëve dhe e Paralizës së Fëmijëve të Gjakovës - Handikos Gjakovë;
 3. OJQ, Autizmi, Prishtinë;
 4. OJQ, Shoqata Humanitare e Prindërve me Persona me Aftësi të Kufizuara Mendore "Hadër", Prizren.
- II. **REFUZOHEN** kërkesat e OJQ-ve sipas thirrjes publike të Ministrisë së Drejtësisë për mbështetje financiare publike për projektet e OJQ-ve të licencuara në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare për vitin 2023 (si më poshtë nga nr. 1-2):
1. OJQ, Shoqata e Personave me Nevoja të Veçanta të Malishevës, Handikos – Malishevë;
 2. OJQ, Shoqata e Personave me Aftësi të Kufizuara të Mitrovicës, Hanidkos - Mitrovica.

Arsyetim

OJQ-të sipas pikës I të këtij vendimi kanë dorëzuar dokumentacionin e plotë përkitazi me thirrjen publike të Ministrisë së Drejtësisë dhe kanë plotësuar të gjitha kriteret e parapara me këtë thirrje

dhe Rregulloren përkatëse, andaj Komisioni ka vendosur për financimin e projekteve të propozuara.

Ndërkaq, sa i përket OJQ-ve nga pika II e këtij vendimi, respektivisht, OJQ, Shoqata e Personave me Nevoja të Veçanta të Malishevës, Handikos – Malishevë dhe OJQ, Shoqata e Personave me Aftësi të Kufizuara të Mitrovicës, Hanidkos - Mitrovica, të njëjtat me rastin e aplikimit nuk kanë ofruar dëshmi që janë të licencuara në ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare, ashtu siç kërkohet në pikën 10 të thirrjes publike të datës 17.08.2023, ku është përcaktuar se:

Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të:

- Të regjistruara dhe licencuara sipas Udhëzimit Administrativ nr. 02/2020 nga MFPT/DPSF-ja;
- Që janë në procedurë të licencimit por që kanë plotësuar kushtet dhe kriteret e Udhëzimit Administrativ nr. 02/2020 nga MFPT/DPSF-ja dhe kanë Vendim aprovues nga Komisioni për Licencim.
- Që nuk kanë qenë përfituese nga mbështetja financiare nga buxheti i Ministrisë së Drejtësisë për vitin 2023.

Këshilla juridike: OJQ-të e pakënaqura me këtë Vendim mund të parashtrojnë ankesë me shkrim në Komisionin e Ankesave në Ministrinë e Drejtësisë, në afat prej 5 ditësh nga data e shpalljes së këtij Vendimi në ueb-faqen e MD-së.

Komisioni vlerësues:

Skender Jahaj _____

Albulena Uka _____

Ylber Kokollari _____

Fehmi Ibrahimj _____

Lendita Elshani _____